

**DRAFT VNM PER KONSULTIMIN ME
PUBLIKUN**

PER SUBJEKTIN : “ SHAGA” SH.P.K

**PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B: VEPRIMTARI
TË TJERA QË PËRFSHIJNË PËRDORIMIN E SOLVENTËVE ID
7.12, k. VEPRIMTARITË E LYERJES/VESHJES TË
APLIKUARA NË SIPËRFAQE DRURI PRODHIMI I
MOBILJEVE**

Subjekti: Shaga sh.p.k

Tirane, 2017

➤ INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM & METODIKËN E ZBATUAR

Gjëndja e mjedisit dhe përkujdesjet ndaj tij, janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerezimit sot. Zhvillimi ekonomik i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numërit të ndërmarjeve operuese, zhvillimit urbanistik të zonave urbane dhe turistike, si pasojë kërkesave të investitoreve të ndryshëm, si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis të zonave të destinuar për zhvillim. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm nëse nuk parashikon hapsira për mbrojtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit, si në ajër, ujë dhe tokë.

Mbrojtja e mjedisit si një sistem dinamik që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, i duhet analizuar jo vetëm faktorët natyror, por edhe aktiviteti njerëzor i cili lidhet me to. Studimet dhe ndërtimet kur nuk menaxhohen konform ligjeve dhe rregullave të natyrës, ato mund të prishin ekuilibrin e natyrës përreth. Planifikimi urban si një veprimtari komplekse, natyrore, inxhinjerie, klimatike, biologjike, sociale dhe legjislativë e shoqërisë njerëzore të civilizuar, mbështetet në radhë të parë mbi mjedisin gjeologjik dhe ekosistemet e lidhur me të.

Ai ka dy aspekte veprimtarish:
Së pari, ndryshimet që njeriu i bën gjeomjedisit dhe ekosistemeve për të pershtatur ato me kërkesat e tij jetësore, sipas filozofisë “njeriu e ndryshon natyrën” për të përmirësuar jetesën e tij.
Së dyti, impaktet e këtyre ndryshimeve mbi vetë mjedisin gjeologjik si dhe mbi jetën e njerëzve. Për të realizuar planifikimin urban dhe për të vlerësuar impaktet mbi gjeosistemin, janë të domosdoshme njohuritë mbi gjeomjedisin dhe ndryshimet që ai pëson me kohën. Këto njohuri nxirren nga vërtetime komplekse gjeologjike, gjeofizike, gjeokimike dhe hidrogjeologjike. Qëllimi i këtij dokumenti bazohet në planifikimin e territorit që i është nënshtruar zona bazuar në studimin urbanistik të zonave, zona e marre në studim i përket zonave me qëllim “Ndërtimin e Hotelit me 9 kate dhe bodrum”.

➤ **BAZA LIGJORE**

Baza Ligjore	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr. 10463, date 22.9.2011	Per menaxhimin e integruar te mbetjeve
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Ligji Nr.7875, datë 23.11.1994	Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë” I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9219 datë
Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9791 datë
Ligji nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhornuar
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për
Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Ligji Nr. 7643, 09.12.1999 I ndryshuar	Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror
Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005	Për eficientësin e energjisë
Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta I ndryshuar me :Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
Ligji Nr. 10 463, datë 22.9.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr. 13, datë 4.01.2013	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit

V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006	“Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor
VKM Nr.123, datë 17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr. 804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e
VKM Nr. 803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
VKM Nr. 247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen
VKM Nr. 575, datë 24.6.2015	Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005	Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve
Vendim Nr. 229, date 23.4.2014	Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe informacionin qe duhet te perfshihet ne dokumentin e
Vendim Nr. 608, date 17.9.2014	Per percaktimin e masave te nevojshme per grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret
Vendim Nr.452, date 11.7.2012	Per lendfilllet e mbetjeve
VKM nr. 177, date 6.3.2012	Per ambalazhet dhe mbetjet e tyre
Vendim Nr. 333, date 26. 01. 2011	“Për Administrimin e Vënddepozitimeve Rajonale të
VKM Nr.114, datë 27.01.2009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të
VKM Nr. 686, datë 29.7.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e

Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe
Rregullore	
Rregullorja Higjeno-Sanitare datë.17.11.1997	Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e
Rregullore, Nr.1, datë 30.03.2007	Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre

➤ **PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

Zona në të cilën ndodhet aktiviteti është në rrugën Hamdi Pepa, ish Parku I Industrisë, Tiranë. **PRODHIMI I MOBILJEVE** është hapësirë e nevojshme për ushtrimin e këtij aktiviteti kati i parë i një godine 3 kateshe. Në të operojnë teknologjia dhe instalimet perkatese, ambientet e shërbimeve mbështetëse dhe parkimi. Sipas natyrës së operacioneve që realizojnë teknologjia e projektit përbehet nga: 1. Tavoline pune 2. Magazina 3. Sharra 4. Dhoma e lëvizjes së mobiljeve 5. Njësi të shërbimeve mbështetëse . Showroom-et.

Godina për prodhimin e mobiljeve pastrohet rregullisht si brenda, ashtu edhe rrethinat e jashtme dhe mbetjet urbane të akumuluar depozitohen në koshat më të afërta të plehrave të vendosura nga Bashkia Tiranë, për këto subjekti paguan taksat e bashkise. **PRODHIMI I MOBILJEVE** është teresisht e mbyllur dhe me kontakte tepër minimale me elementet e mjedisit. Mbetjet e drurit, dhe tallashi thithen nga makinertë me aspirator të fuqishëm dhe depozitohen në një depozite dhe këto mbetje u shiten furrave të bukës dhe picerive, pra teknologjia nuk lë asnjë lloj mbetje pasi çdo mbetje që është prej druri përdoret për një qëllim të caktuar.

➤ **NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

1. Nuk ka prodhim të mbëtjeve të rrezikshme
2. Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikoj në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonën ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
3. Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
4. Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
5. Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
6. Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
7. Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
8. Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmës nuk i kalon vlerat maksimale gjate punës në kete mobilerie. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
9. Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
10. Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.

➤ **MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

Ne zbatim te projektit do te ngrihet infrastruktura baze, duke filluar nga rruget automobilistike, kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza, rrjeti i furnizimit me energji elektrike te specifikuara si me poshte:

Ne sheshin e objektit ka hapësire te mjaftueshme per parkimin e automjeteve qe vijne per tu furnizuar prane kesaj mobilerie. Keshtu nuk do te kete ndryshim te infrastruktures ekzistuese.

Do behet kanalizimi e ujrave te bardha rreth objektit per te shmangur erozionin e tokes.

- ***Rrethimi i objektit***

Rrethimi i objektit behet per te shmangur daljen e cdo lloje mbeturine jashte territorit dhe ne te njejten kohe per te disiplinuar cdo lloje hyrje ne objektin te personave qe nuk kane lidhje pune me kete aktivitet.

- ***Furnizimin me uje***

Uji i pijshem, do te merret nga tubacioni kryesor i ujesjellesit te zones. Uje per perdorim per mbrojtjen nga zjarri, per vaditje te lulishtes, per pastrim e tjera do te sigurohet nga subjekti nepermjet sigurimeve vetjake.

Lidhja e objektit me tubacionin kryesor te ujesjellesit dhe kontrata per vendosjen e kontatoreve behet me marrveshje me ndermarrjen e ujesjelles kanalizime.

- ***Rrjeti i kanalizimeve***

Ne funksion te nevojave te objektit , do te ndertohet nje system i ri kanalizimi qe ujrato e zeza te derdhen ne kolektorin kryesor te zones.

- ***Evadimi i mbeturinave***

Per evadimin e mbeturinave do te perdoren kazana per plehrat.

Evadimi dhe transporti i tyre do te behet nga subjekti ne vendet e caktuara nga pushteti lokal

- ***Mbrojtja nga zhurmat***

Ndikimi nga zhurmat jane minimal dhe te pakonsiderueshme per keto arsye:

Ne zonen e zhvillimit te aktivitetit nuk ka objekte sociale si shkolla, spitale, etj qe zhurmat e krijuara gjate futjes se automjeteve ne servis te ndikojne negativisht tek ato. Gjate furnizimit te bleresve me mobilje nuk shkaktohen zhurma. Punonjesit do te perdorin gjate punes mjete mbrojtese individuale nga zhurmat.

- ***Mbrojtja nga gazet***

Sasia e gazeve te cliruara nga motorrat e automjeteve qe hyjne ne mobileri do te jete e paperfillshme.

- ***Gjelberimin territorit per rreth tij.***

Territori i lire ne objekt dhe per rreth tij do te gjelberohet, duke e mbjelle me peme me gjelberim gjithe vitit.

➤ PËRSHKRIMI I MONITORIMIT TË MJEDISIT

Monitorimi ne vetvete eshte nje proces i zbulimit te ndryshimeve nese ato ndodhin, si dhe i percaktimit te drejtimit dhe matjes se shtrirjes se tyre. Monitorimi mjedisor i aktivitetit ka si qellim te ofroje te dhena lidhur me ndikimet faktike ne mjedis te aktivitetit gjate fazes se ushtrimit te veprimtarise si dhe marrjen e masave te nevojshme per rritjen e performances mjedisore te veprimtarise.

Indikatorët dhe parametrat e monitorimit mjedisor do te perqendrohen kryesisht ne shkarkimet ne mjedis te veprimtarise edhe pse ato parashikohen minimale per shkak te natyres se aktivitetit dhe teknologjise qe do te perdoret. Monitorimi do te kryhet nga vete investitori dhe ne rast te pamundesise teknike per realizimin e tyre do te kerkohet bashkepunimi i subjekteve te specializuara per fushat perkatese.

Elementet e monitorimit mjedisor te veprimtarise

Nr.	Elementi i monitoruar	Frekuenca	Shpjegime
1	Monitorim i gjendjes se mekanikes	Vazhdueshem	Ne menyre periodike behet kontrolli i automjeteve.
2	Monitorim i funksionimit te kanalit perimetrik dhe kontrollit te ujerave te shiut	Vazhdueshem	Pastrohen vazhdimisht ne varesi te mases
4	Monitorimi i ngritjes se pluhurave ne objekt dhe gjate punes	Vazhdueshem	Lagia e ambientit dhe rrugeve.
5	Monitorim i te gjithe masave te parashikuara per zbutjen e ndikimeve	Periodik	Behen analize dhe shqyrtim i efektivitetit te masave te marra hap pas hapi.
6	Monitorim i zhurmave	Periodik	Behet matja e zhurmave ne

			disa pika te territorit.
7	Monitorimi i ujerave	Periodik	Meret moster uji per ta analizuar.

➤ PËRSHKRIMI I INCIDENTEVE

Persa i perket strukturese se menaxhimit te aktivitetit per prodhimin e mobiljeve nga ana e administratorit te shoqerise eshte bere edhe ndarja e detyrave dhe puneve qe do kryeje secili nga punonjesit. Aktiviteti nuk perdor lende te demshme dhe te rrezikshme si per mjedisin ashtu edhe per punonjesit. Per shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerite tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e gjendjes se tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik.

• PLANI I PERBALLIMIT TE EMERGJENCAVE DHE AKSIDENTEVE

Ne specifiken e punes te subjektit Shaga sh.p.k , rreziku me emergjent dhe me probabel ndaj te cilit duhet gjithnje vemendje dhe gadishmeri e vecante eshte ai qe vjen nga **ZJARRI** i shkaktuar objektivist apo subjektivisht.

Duke punuar per vleresimin real te riskut dhe per te perballuar cdo rrezik nga zjarri ne kete Baze jane te instaluar **MJETET** e Mbrojtjes nga Zjarri dhe funksionojne **MASAT** permanente dhe **STRUKTURAT** e trajnuara per parandalimin dhe luften per shuarjen e zjarrit. Ne rastet e renies se zjarrit jane percaktuar procedurat dhe masat per parandalimin dhe shuarjen e tij, te cilat konsistojne si me poshte :

- Instalimi kompletimi dhe funksionimi i te gjitha mjeteve dhe paisjeve te shuarjes se zjarrit si Fikse zjarri me shkume 50 ,9 dhe 6 litroshe te vendosura ne vendet e duhura, sistemi komplet i luftes me shkume dhe me uje te ftohte, kendet e MNZ me vegla, tubo te linjta dhe fuçi me uje e rere, kasetat e hidranteve ne te gjithe territorin dhe tabelat paralajmeruese

se bashku me kendin e afishimit te rregulloreve dhe instruksioneve per luften ndaj zjarrit.

- Funksionon Struktura e GRUPIT te SHUARJES se Zjarrit ku perfshihen te gjithë punonjesit e Bazes si dhe personeli prezent i SH.R.S.F (policia private). Kjo strukture instruktohet rregullisht dhe periodikisht bazuar ne Regulloret e disponueshme dhe te miratuara per parandalimin dhe luften ndaj zjarrit. Behen here pas here teste gadishmerie te reagimit dhe veprimeve ne rast zjarri.
- Te gjithë dine **NUMRIN 128** te lajmerimit te **Policise se MKZ**(zjarrfikses).
- Te gjithë personat instruktohen vazhdimisht mbi skemen dhe veprimet teknike per venien ne pune te sistemit te SHKUMES dhe UJIT FTOHES dhe dergimin ne destinacionin e rrezikut.
- Behet kontrolli dhe pastrimi sistematik i barerave dhe shkurreve nga territori.
- Jane gjithnje ne gadishmeri Rruget te lira per ne cdo objekt per ndihme ne rast zjarri.
- Kontrollohen vazhdimisht gjeneroret e Shkumes ne cdo Depo per funksionim normal dhe grasatohen nyjet levizese.
- Grasatohen periodikisht te gjitha Saracineskat dhe nyjet e tjera te linjave te te gjithë sistemit per mos ndryshkje dhe funksionim te lehte.
- Zbatohen masat parandaluese te perdorimit nga cdo person qe hyn ne Baze te MJETEVE NDEZESE dhe zjarrshkaktuese direkt dhe nepermjet instruksioneve dhe tabelave te vendosura.
- Kontrollohet sistemi tokzim-rrufeprites dhe behen matje periodike te vlerave te tyre.

➤ **KONKLUSIONE**

1. Vlerësohet puna e bërë nga drejtuesit e shoqërisë **Shaga sh.p.k** në drejtim të disiplinimit të veprimeve në mbajtjen e vlerave të intervenimit të agjentëve kimik, fizik e biologjik në mjediset e punës dhe në impaktin në mjedis të këtyre elementëve, duke përdorur teknologji moderne dhe automatike të cilat bëjnë të mundur një punë me efikasitet dhe një impakt minimal në ambient.

○ **Detyrimet e punëdhënësit**

Punëdhënësi vetë ose nëpërmjet drejtuesit teknik që ka punësuar, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajturi shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Përveç sa më sipër punëdhënësi ka detyrë që :

- Të sigurojë për çdo rast ndihmën e parë mjeksore.
- Të vendos në territorin e instalimit , në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

- Të bëjë instuktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

Detyrimet e punëmarrësit

- Të njoh mirë procesin e punës dhe makinerit apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojnë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë ç'masa duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.